KONCEPT DOKUMENT PRELIMINAR

Trajnim Ndërmejtësimi me bazë në Komunitet për Gratë Lidere në Kosovë

Informata të përgjithshme

Rezoluta historike për Siguri 1325 e Kombeve të Bashkuara në vitin 2000 shpalli rolin esencial të grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe theksoi pjesëmarrjen e tyre të barabartë në promovimin e paqes dhe sigurisë. Megjithatë, përkundër kësaj rezolute - dhe një sërë rezolutash dhe planeve të tjera kombëtare të veprimit që promovojnë pjesëmarrjen e plotë të grave në ndërmjetësim, parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve - përfshirja e grave në ndërmjetësime të rangut të lartë dhe marrëveshje të tjera të paqes ka qenë një proces i ngadalshëm.

Një studim i vitit 2012 nga UN Women, i cili rishikoi 31 procese të mëdha të paqes, zbuloi se gratë përbëjnë vetëm 4 përqind të nënshkruesve të marrëveshjeve të paqes, 2.4 përqind të ndërmjetësve kryesorë, 3.7 përqind të dëshmitarëve ose vëzhguesve në negociatat për paqe dhe 9 përqind të anëtarëve të ekipit negociues.

Në Ballkanin Perëndimor, gratë vazhdojnë të mbesin jashtëzakonisht të nënpërfaqësuara në bisedimet zyrtare për paqe, edhe pse ato kanë qenë të përfshira dhe kanë kontribuar në përfundimin e konflikteve dhe janë angazhuar në ndërtimin e paqes dhe në proces të pajtimit pas konflikteve. Në pesë proceset ndërkombëtare të paqes dhe marrëveshjet e nënshkruara të paqes (Marrëveshja e Dejtonit 1995, Marrëveshja e Rambujesë 1999, Bisedimet për Paqe në Vienë 2005-2006, Marrëveshja e Erdutit 1995, Marrëveshja e Ohrit 2001) dhe në Dialogun në vazhdim të Brukselit në këtë rajon për më shumë se 25 vite, vetëm një grua ka qenë e pranishme në bisedimet zyrtare për paqe dhe si Kryenegociatore, që është Kryesuesja e LRGEJL-së Edita Tahiri, ish-Zëvendës Kryeministre dhe Ministre për Dialog e Kosovës. Ka qenë edhe një negociatore grua në Kroaci, Vesna Skare Ozbolt, ish-Ministre e Drejtësisë, e cila ka qenë pjesë e bisedimeve lidhur me procesin e riintegrimit. Gratë duhet të fuqizohen për të marrë pjesë në proceset e paqes. Gratë kanë vlera të ndryshme për dallim nga burrat lidhur me paqen dhe kanë kapital strategjik që duhet të vihet në front.

Gjatë debatit të hapur të Këshillit të Sigurimit të vitit 2018 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, themelimi i disa rrjeteve të grave u theksua si një rol kryesor në ndikimin dhe avancimin e proceseve të negociatave me përgjegjësi gjinore. Rrjeti i Grave të Kosovës dhe Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore (LRG EJL) janë dy rrjete të tilla që

kanë theksuar vazhdimisht nevojën për pjesëmarrjen e grave në të gjitha proceset e dialogut politik dhe që kanë luajtur një rol kyç në avancimin e çështjeve prioritare për të dhënë informata dhe udhëzime për diskutime të tilla.

Që nga fillimi i vitit 2000, udhëheqëset e komuniteteve të grave kanë dhënë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm drejt pajtimit dhe ndërtimit të besimit. LRG EJL **ka organizuar një sërë takimesh në terren** me gratë nga komunat e Kosovës për të diskutuar për fuqizimin e grave dhe pjesëmarrjen në ndërtimin e besimit dhe për avancuar rolin e tyre në nxitjen e dialogut ndër-komunitar dhe mbështetjen e proceseve të paqes në përputhje me Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325. Me mbështetjen e OKB-së, dy organizata nga rajoni i Mitrovicës, Mundesia dhe të Drejtat e Grave, gjithashtu bashkë-themeluan Iniciativën e Grave të Mitrovicës për Ndërtimin e Besimit për të mbështetur bashkëpunimin dhe dialogun ndër-komunal.

Përkundër këtyre përpjekjeve, mbetet një boshllëk sa i përket punës drejt ndërtimit të paqes për gratë udhëheqëse në nivel komuniteti dhe proceset e nivelit të lartë të dialogut politik , ku pikëpamjet dhe përvoja e grave përfshihen sistematikisht . Në mënyrë që ky boshllëk të mbushet, propozohet bashkëpunim në mes të LRG EJL, Kombeve të Bashkuara dhe udhëheqëseve të komuniteteve të grave nga Kosova për të hartuar dhe zbatuar trajnim vendor dhe gjithëpërfshirës ndërmjetësimi për t'i ndihmuar ato drejt ndërlidhjes së përvojës që kanë në avokim, ndërtim të paqes dhe ndërmjetësim joformal me proceset politike të nivelit të lartë që janë në zhvillim e sipër në mënyrë që prioritetet dhe nevojat e identifikuara të grave të reflektohen dhe të përfaqësohen më mirë gjatë të gjitha fazave të negociatave në vazhdim e sipër.

Qëllimi:

Gratë nga komunitetet lokale në Kosovë zhvillojnë aftësitë e tyre për negociata / ndërmjetësim, në mënyrë që të avancojnë qëllimet drejt ndërtimit të besimit dhe të paqes.

Qasja e propozuar:

Hapi 1: Punëtori e hartimit konceptual që përfshin anëtarët e Komitetit Drejtues të LRG EJL, udhëheqësit kryesorë lokalë nga Kosova dhe ekspertët teknikë të Njësisë Mbështetëse të Ndërmjetësimit të OKB-së për t'i diskutuar nevojat dhe pritjet për trajnimin e ndërmjetësimit dhe për të rënë dakord për një metodologji për nxjerrjen e një trajnimi të tillë.

Hapi 2: Hartimi i trajnimit: Zhvillimi i trajnimit i udhëhequr nga një ekip që përbëhet nga praktikuesë dhe ekspertë kompetentë të ndërmjetësimit si dhe me angazhimin dhe përfshirjen e anëtarëve të shquar të LRG EJL.

Hapi 3: Punëtori trajnimi për udhëheqëset e komuniteteve të grave në Kosovë nga ekspertët e UN MSU-së në bashkëpunim me LRG EJL.

Hapi 4: Vlerësimi dhe aktivitetet përcjellëse

Afati i propozuar kohor:

11 mars	Punëtoria konceptuale e propozuar
Prill-Maj	Zhvillimi / pilotimi i materialeve të trajnimit
Korrik	Trajnimi i LRG EJL
Shtator	Punëtori trajnuese për udhëheqësit e Kosovës